



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada-Government*

**MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË**  
**MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE NAUKU I TEHNOLOGIJU**  
**MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE AND TECHNOLOGY**

**Informatë për kandidatët e interesuar për regjistrim në Shkollat e Larta  
Profesionale**

Nisur nga interesimi i shtuar i kandidatëve të cilat nuk e kanë kaluar provimin shtetëror të maturës, MASHT sqaron se në sektorin e arsimit të lartë në Kosove tanimë është bërë edhe akreditimi dhe licencimi i shkollave të larta profesionale - të parat në Republikën e Kosovës (dhe në regjion) të cilat ofrojnë diploma dhe trajnime (në nivelet 4, 5 dhe 6 sipas EQF) në përputhje me UA 12/2009.

MASHT njofton të interesuarit se në programet e nivelit 4 sipas EQF mund të regjistrohen edhe kandidatët të cilët nuk e kanë kaluar provimin e maturës. Në nivelet 5 dhe 6 të Shkollave të Larta Profesionale, mund të regjistrohen kandidatët të cilat e kanë kaluar me sukses provimin e matures.

Kandidatët e tillë (të cilët nuk e kanë kaluar provimin e maturës) mund të informohen në Agjensionin Kosovar për Akreditim dhe në MASHT për institucionet të cilat ofrojnë programe të nivelit 4 sipas EQF. Informata për institucionet të cilat janë akredituar për të ofruar programe të nivelit 4 sipas EQF mund të merret edhe nga [vendimi](#) i Qeverise i cili gjindet ne web-faqen e MASHT-it.